



# Ju jeni ndaluar sipas një mandat-arresti evropian dhe jeni dërguar në një rajon (policie) ose në një vendndodhje tjetër për marrje në pyetje

## Albanees

### Cilat janë të drejtat tuaja?

Një shtet anëtar i Bashkimit Evropian i ka drejtuar një kërkesë Shërbimit të Prokurorisë Publike të Holandës për dorëzimin tuaj. Kjo është arsyeja pse jeni ndaluar nga policia, Shërbimi Mbretëror Marechaussee i Holandës ose një shërbim tjetër hetimor. Është e rëndësishme që ju të dini të drejtat dhe detyrimet tuaja. Sigurohuni që ta lexoni këtë fletë informative me kujdes.

### Procedura pas arrestimit tuaj dhe të drejtat tuaja

Pas arrestimit tuaj, (Zëvendës) Prokurori Publik do të vendosë nëse duhet të qëndroni ose jo në rajonin e policisë. Ju nuk jeni i detyruar t'u përgjigjeni pyetjeve të tij/saj.

### E drejta për avokat

Hetuesi do të sigurohet që ju të keni qasje të një avokat holandez sa më shpejt pas arrestimit tuaj. Ky avokat më pas do t'ju kontaktojë. Ju gjithashtu jeni i lirë të merrni një avokat që mund ta njihni vetë. Në këtë rast, ju lutemi njoftoni hetuesin.

Ju keni të drejtën të flisni me avokatin tuaj në konfidencë. Përpara se të merreni në pyetje në lidhje me mbajtjen tuaj nën arrest nga policia, juve ju lejohet të konsultoheni deri në gjysmë ore me avokatin tuaj. Edhe avokati juaj mund të marrë pjesë në marrjen tuaj në pyetje dhe mund të ofrojë asistencë.

Megjithatë, kini parasysh se mund të duhet pak kohë përpara se avokati të mbërrijë në vendin e marrjes në pyetje. Si rregull i përgjithshëm, avokati juaj duhet të mbërrijë në vendin e marrjes në pyetje brenda pak orësh pas marrjes së njoftimit nga policia.

Shërbimet e një avokati holandez zakonisht janë pa pagesë, përveçse kur merrni avokatin tuaj dhe ai/ajo nuk është i/e regjistruar pranë Bordit të Ndhmës Ligjore. Në këtë rast, ju duhet t'i përballoni vetë kostot.

*Nëse autoriteti hetimor ia kalon të dhënat tuaja personale Bordit të Ndhmës Ligjore me qëllim marrjen e një avokati, të dhënat tuaja do të përpunohen në sistemin administrues të Bordit.*

### Marrja e një avokati të huaj

Ju mund të kërkonti gjithashtu shërbimet e një avokati në shtetin anëtar të BE-së që ka kërkuar dorëzimin tuaj. Ky avokat i huaj mund t'i japë informacione dhe këshilla avokatit tuaj holandez rreth procedurës së dorëzimit. Megjithatë, kini parasysh se mund t'ju kërkohet që t'i përballoni vetë kostot e marrjes së një avokati të huaj. Nëse dëshironi ta përdorni këtë shërbim, Prokurori Publik do t'ia kalojë kërkesën tuaj menjëherë autoriteteve të vendit që kërkon dorëzimin tuaj.

Autoritetet e vendit që kërkon dorëzimin tuaj më pas do t'ju japin informacion rreth mundësive të marrjes së një avokati edhe në atë vend. Nëse zgjidhni këtë opsion, do të jeni ju përgjegjës për të kontaktuar vetë këtë "avokat të dytë". Për këtë mund t'ju ndihmojë avokati juaj holandez.

Më poshtë jepen informacione rreth shërbimeve që mund të përfitoni nga një avokat.

### E drejta për përkthyes

Ju do të keni të drejtën e ndihmës së një përkthyesi nëse holandishten e flisni apo kuptoni shumë pak ose aspak. Ju lutemi njoftoni hetuesin nëse nuk e kuptoni mirë atë. Ai/ajo do të thërrasë një përkthyes për ju. Përkthyesi mund të ndihmojë gjithashtu edhe me bisedat me avokatin. Ky shërbim ofrohet pa pagesë.

### Në rajonin e policisë

Ju mund të mbaheni i ndaluar, për shembull në një rajon policie, për jo më shumë se tri ditë. Nëse është e rëndësishme që të mbaheni i ndaluar për një periudhë më të gjatë, Prokurori Publik mund të vendosë që ndalimi juaj të zgjatet me maksimumi edhe tri ditë të tjera.

Ju mund t'i kërkonti hetuesit të njoftojë një palë të tretë (p.sh. një anëtar familjeje ose person që banon me ju) rreth faktit se po mbaheni i ndaluar.

Nëse nuk jeni shtetas holandez, mund t'i kërkonti hetuesit që të njoftojë konsullatën ose ambasadën e vendit tuaj të origjinës rreth ndalimit tuaj.

### Të drejta të tjera

Ju do të merrni një kopje të mandat-arrestit evropian. Nëse mandat-arresti evropian është shkruar në një gjuhë që ju nuk e kuptoni, ju keni të drejtën të kërkonti përkthim të pjesëve më të rëndësishme të mandat-arrestit.

Ju lutemi njoftojeni hetuesin nëse ndiheni i sëmurë, nëse dëshironi të vizitoheni nga një mjek ose në rast se keni nevojë për kujdes urgjent mjekësor, si p.sh. për një medikament.

### Çfarë veprimesh do të marrë avokati?

Avokati do të mbrojë interesat tuaja. Avokati juaj holandez:

- mund t'ju tregojë rreth rrjedhës së procedurës;
- mund t'ju japë këshillë ligjore;
- mund t'ju njoftojë rreth të drejtave dhe detyrimeve tuaja;
- mund t'ju tregojë anët pozitive dhe negative nëse bini dakord për t'u dorëzuar dhe implikimet që do të ketë kjo për ju (shikoni gjithashtu më poshtë);
- mund të kontaktojë me familjen ose punëdhënësin tuaj, për t'i njoftuar rreth situatës suaj;
- mund të kontaktojë me avokatin tuaj në vendin që kërkon dorëzimin tuaj;
- mund t'ju ndihmojë përpara dhe gjatë marrjes në pyetje nga hetuesi, si edhe gjatë procedimeve të nisura nga gjykata në rast se ju nuk bini dakord që të dorëzoheni (shikoni gjithashtu më poshtë).

Nëse zgjidhni të flisni me një avokat, kjo nuk do të thotë se ju pranoni fajin. Çdo gjë që i tregoni avokatit do të mbetet konfidencial. Hetuesi nuk do t'i dëgjojë bisedat tuaja. Avokatit tuaj nuk i

lejohej të flasë me palë të tjera rreth çështjes suaj pa lejen tuaj. Kjo përfshin edhe hetuesin. E njëjta gjë zbatohet edhe për përkthyesin, nëse përdorni shërbimet e tij/saj për të folur me avokatin.

Nëse, me kërkesën tuaj, ju caktohet një avokat në shtetin anëtar që kërkon dorëzimin tuaj, ky "avokat i dytë" mund t'i japë avokatit tuaj holandez këshilla dhe informacione të cilat ai/ajo mund t'i përdorë në procedurën e dorëzimit tuaj. Megjithatë, procedurën e dorëzimit për ju do ta kryejë avokati juaj holandez.

### Çfarë ndodh më pas?

Nëse jeni i ndaluar diku tjetër në Holandë, ju do të transferoheni në Amsterdam pas periudhës së ndalimit. Atje, Prokurori Publik ose gjykatësi që shqyrton çështjen do të vendosë nëse është nevoja të qëndroni në ndalim për një periudhë më të gjatë. Nëse është kështu, ju do të transferoheni në një qendër paraburgimi. Ju lutemi flisni me avokatin tuaj rreth hapave që mund të merrni nëse nuk bini dakord të mbaheni në ndalim për një periudhë më të gjatë.

Nëse nuk bini dakord me dorëzimin tuaj, gjykatësi do të vendosë nëse do të dorëzoheni te shteti anëtar që ka kërkuar dorëzimin. Në një seancë rreth kësaj çështjeje, gjykatësi do t'ju drejtojë disa pyetje. Edhe gjatë kësaj seance, ju do të keni të drejtën e pranisë dhe asistencës së një avokati holandez. Ju gjithashtu keni të drejtën të refuzoni pjesëmarrjen në seancë dhe të kërkonti që të përfaqësoheni nga avokati juaj.

### Rënia dakord për t'u dorëzuar

Ju mund të bini dakord që të dorëzoheni nëse nuk keni kundërshtime ndaj kërkesës së shtetit anëtar që kërkon dorëzimin. Kjo mund ta përshpejtojë procedurën. Megjithatë, nëse bini dakord të dorëzoheni, kini parasysh se:

- ju nuk do të jeni në gjendje ta ndryshoni vendimin tuaj në një datë të mëvonshme;
- çështja juaj nuk do të shqyrtohet sërish nga gjykatësi;
- vendimin për dorëzimin tuaj do ta marrë Prokurori Publik dhe jo gjykatësi;
- duke prepruar kështu, ju do të humbni statusin tuaj të mbrojtur sipas "rregullit të veçantisë", që do të thotë se pas dorëzimit tuaj në shtetin tjetër anëtar, ju mund të ndiqeni edhe për shkelje të tjera përveç atyre që deklarohen në mandat-arrestin evropian.

Rreth kësaj mund t'ju japë informacione të mëtejshme avokati juaj holandez.

Nëse dëshironi të bini dakord me dorëzimin tuaj, ju duhet t'i jepni një deklaratë për këtë qëllim Prokurorit Publik ose gjykatësit që shqyrton çështjen. Ju mund të kërkonti që në këtë procedurë të marrë pjesë avokati juaj holandez.

### Keni pyetje?

A keni ndonjë pyetje? Nëse po, drejtojani ato avokatit tuaj holandez ose hetuesit.

#### **Detajet e publikimit**

Kjo fletë informuese është publikuar nga Ministria e Sigurisë dhe e Drejtësisë

PO Box 20301 | 2500 EH The Hague | Holandë

Maj 2017 | 103170

*Nga përmbajtja e kësaj flete informuese nuk mund të përfitohet asnjë e drejtë.*